



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 075/15
Prishtinë, më 12 qershor 2009, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 QERSHOR 2009**

Seancën e drejtoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kurse i ndihmoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 54 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amandamentim të rendin të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008

Kryesuesi njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008 dhe Kuvendit i ka rekomanduar që të procedohet për diskutim në seancë plenare.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008.

Ministri për Ekonomi dhe Financa, Ahmet Shala tha se është e pakontestueshme performanca e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë së taksapaguesve kosovarë dhe se plani buxhetor i të hyrave vjetore për vitin 2008 ka qenë 888.900.000 euro, kurse plani i shpenzimeve vjetore prej 1.177.944.000 euro.

Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2008, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe Fondin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, përkatësisht Agjencionit Kosovar të Privatizimit, kanë qenë 942.525.000 euro dhe paraqesin se 106% të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara. Kjo tregon një rritje vjetore të hyrave prej 6%, krahasuar me planin vjetor, ndërsa një ngritje prej 14%, krahasuar me vitin 2007.

Të hyrat e mbledhura në kufij, nga Dogana, arrijnë 64% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 604.196.000 euro, gjë që tregon tejkalim të planit për 4% dhe 13,7% tejkalim të planit në krahasim me vitin paraprak.

Të hyrat e brendshme, përkatësisht të hyrat e mbledhura nga Administrata Tatimore, arrijnë 21% të hyrave të përgjithshme dhe shprehur në masë monetare kanë qenë 200.834.000 euro. Edhe në këtë kategori të hyrave është tejkaluar plani për 4% dhe është tejkaluar një ngritje prej 10%, krahasuar me më vitin paraprak.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 5% në shumën prej 42.784.000 euro, me një tejkalim të planit buxhetor prej 12% dhe një tejkalim në vitin paraprak për 46,3%. Konsideroj se këtu kanë qenë të arriturat më të suksesshme në gjithë të hyrat e brendshme.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë më 3% dhe kapin shumën prej 29.66.000 euro, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një ngritje prej 13%.

Të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 7% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 65.645.000, që paraqet një tejkalim të planit buxhetor për 29%.

Të dalat nga kategoria e pagave dhe e mëditjeve, janë 227.091.000 euro ose 24% të dalave të përgjithshme. Të dalat nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë 139.371.000 eurove ose 15% e të dalave të përgjithshme, me një realizim prej 83% të planit vjetor.

Të dalat në kategoritë e shërbimeve komunale kapin shumën prej 13.481.000 euro apo 2% e të dalave të përgjithshme, ndërsa realizimi ndaj planit ka qenë 86%.

Subvencionet e transferet janë 209.769.000 euro ose 22% të dalave të përgjithshme, me një realizim vjetor prej 95%.

Shpenzimet kapitale kapin shumën prej 347.103.000 euro ose 37% e të dalave të përgjithshme dhe një realizim vjetor prej 80%, përkatësisht një tejkalim krahasuar me vitin paraprak për 124%.

Ai tha se raporti është edhe një tregues që lehët mund të matet sa i përket suksesit të institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese dhe një dëshmi e pakontestueshme për potencialin në rritje në rrugëtimin e sforcimit të mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, tha se raporti i plotëson kushtet ligjore për shqyrtim dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008.

Pra, lidhur me këtë raport, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, ndër të tjera nënvizoi se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për vitin 2008 dhe përkrah rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse ky raport teknikisht është më i avancuar dhe është në përputhje me standardet e kontabilitetit.

Nga të dhënat e prezantuara në raport shihet se të hyrat për vitin 2008 kanë pasur një performancë të mirë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Raportin dhe i jep përkrahje Kryeministrit dhe Qeverisë të vazhdojnë me kontrollin e rrjedhës së parasë publike , në mënyrë që të jenë edhe më efikas në luftimin e dukurive negative të trashëguara dhe t'i hapim rrugë zhvillimit ekonomik dhe perspektivës së jetës së qytetarëve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, theksoi se e Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin financiar për vitin 2008. Raporti është në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me të cilin plotësohen kushtet për diskutim dhe raportim.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerëson këtë si raport që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe i jep përkrahje në parim

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, tha se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka marr raportin e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2008 dhe me shumë kujdes e ka shqyrtuar. Në këtë kontekst ne kemi disa pyetje esenciale domethënë, si total se si është menaxhuar paraja publike. Pra, ai pyeti se si ka mundur një abetare sipas çmimit të shitjes me shumicë ka mundur t'i kushtojë buxhetit të Kosovës 15 euro , si mund të shtrohet me para publike rruga në mars e të prishët në shtator , si hapën tenderët për punët e kryera, qoftë për shkolla, qoftë për rrugë?

Ai theksoi se vlera e shpenzuar për telefona është rritur, domethënë, Qeveria në esencë ka shpenzuar tri herë më shumë se paraprakisht për telefona dhe për shpenzime të automjeteve. Për shembull në objektin e Ministrisë së Arsimit, një metër katror i fasadës vlerësohet se kushton 260 euro, ndërsa sa i përket cilësisë së punës vlen 60 euro.

Shpresojmë që Auditori i Pavarur do t'i rishikojë të gjitha këto parregullsi që kanë ndodhur dhe me siguri se do të paraqesë padi penale ndaj personave që kanë shkelur ligjin.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së Ibrahim Gashi, tha se e kemi shqyrtuar materialin dhe natyrisht ai është në përputhje me dispozitat ligjore, i përmbush ato kritere themelore që janë të domosdoshme për t'i përmbushur. Dhe, ajo që në fakt e bën këtë dokument goxha deskriptiv dhe hap vend, për të kërkuar sqarime shtesë nga hartuesit e këtij dokumenti, është se janë paraqitur shumë shifra pa dhënë sqarime plotësuese. Ne jemi përafërsisht në gjysmën e vitit dhe do të duhej që projektet e parapara nga Qeveria për t'u realizuar në këtë periudhë kohore të vitit të ishin diku rreth 50%. Pra, mendoj kemi shumë dikastere të kësaj Qeverie dhe shumë njësi buxhetore që janë ende larg realizimit të projekteve të parapara mbi bazën e cilave është ndarë edhe buxheti. Gjithashtu, është folur me të madhe se Universitetit të Prishtinës do t'i rikthehet autonomia buxhetore, por kjo në praktikë nuk ka ndodhur.

Raporti në parim përmbush kriteret themelore, të kërkuara sipas ligjit.

Në emër të Grupit Parlamentar LDD-së, Besa Gaxherri tha se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Dardanisë i ka shqyrtuar me shumë vëmendje shpenzimet e parasë publike të Kosovës për vitin 2008 dhe realisht mendon ky raport është shqetësues kur shohim se performanca e mënyrës së shpenzimit të parasë është më e dobët se sa në të kaluarën. Ne e kemi shqyrtuar raportin 9- mujor të shpenzimeve të buxhetit të Kosovës dhe kemi parë se kjo Qeveri ka arritur vetëm 40% t'i përmbyllë shpenzimet kapitale, ndërsa në vitin 2008 vetëm për 3 muaj, 40% të shpenzimeve të tjera i ka përfunduar.

Në këtë buxhet për vitin 2008 ka suficit, performanca e shpenzimeve është e dobët. Realisht 20 milionë janë rritur pagat, mirëpo kjo nuk do të thotë që është ngritur paga e qytetarit të Kosovës, por kur e shohim atje dokumentacionin, ka shumë të punësuar nga organizatat buxhetore të Kosovës me kontratë mbi veprën, gjë që është e ndaluar me ligj.

Po e marr një shembull, buxheti i Kosovës është dëmtuar për 1 milion euro për policët serbë, të cilët, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk kanë pranuar të jenë në strukturën e Shërbimit Policor të Kosovës dhe ata janë financuar edhe nga Qeveria e Serbisë, por edhe nga Qeveria e Kosovës, për të kryer punë dhe për të funksionuar këtu si institucione të cilat, ne e dimë së çfarë pune kanë kryer ata.

Kosova ende s'e ka asnjë autostradë me asnjë shtet fqinj dhe nuk e ka asnjë rrugë e cila gjeneron zhvillim ekonomik. Kosovës i shtrohen rrugët atje ku ka nevojë të merren votat dhe nuk mendon askush se cila rrugë gjeneron zhvillim ekonomik dhe me cilin shtet Kosova duhet të ketë, natyrisht, lidhje përmes infrastrukturës rrugore.

Në emër të Grupit Parlamentar të "7+", Myfera Shenik, e mbështeti raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008 me rekomandimet e dhëna.

Në emër të Grupit Parlamentar të "SLS-së", Bojan Stojanoviq, tha se edhe përkundër kritikave që mund t'i bëhen këtij raporti lidhur me implementimin e fushave buxhetore, ne si Grup Parlamentar e mbështetim raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008 me rekomandimet e dhëna.

Gjithashtu, vërejte, sugjerime dhanë: Kaçusha Jashari, Haki Shatri, Myrvete Pantina, Gjylanze Sylja, Adem Salihaj, Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, Ethem Çeku, Hajdin Abazi, Riza Smaka, Synavere Rysha, Lulzim Zeneli, Driton Tali, Mark Krasniqi, Ibrahim Makolli, Gani Koci, Bajram Kosumi, Myfera Shinik, Fehmi Mujota, Xhevdet Neziraj, Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ibrahim Makolli, ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, Ardian Gjini, Shkumbin Demaliaj, Armend Zemaj, Mimoza Ahmetaj, Numan Baliq, Gani Buçinca, Ibrahim Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gani Geci, Sabri Hamiti, Naser Rugova dhe Xhavit Haliti, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverbali.

Në fund, Ministri i Ekonomisë dhe Financave Ahmet Shala, theksoi se nga 99,2% të mjeteve, vetëm në shpenzime kapitale ka pasur 2.157.000 euro, ndërsa në financime së bashku nga Qeveria përmes Ministrisë së Transportit ose të ministrive të tjera, ka edhe ekstra 4 milionë të tjera, të cilat reflektohen në raportet individuale të secilës ministri e që

reflekton përafërsisht mesataren e investimeve nëpër komuna karshi proporcionit të popullsisë ose nevojave që ka pasur në projektet e veta.

Në ligjin që e keni miratuar del se Banka Qendrore e Kosovës është menaxhues i parasë publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës, që investon paratë e buxhetit të Kosovës, paratë e fondeve të tjera konform praktikave dhe mundësive më të mira, qofshin ato në Kosovë, qofshin ato jashtë Kosovës. Pra, Qeveria po përgatit Ligjin për huat dhe ligjet e tjera të cilat do t'i sjellin këto para në vendin tonë dhe këtë vit, shumë shpejt, do të vijë Ligji për huat publike, i cili paraqet edhe menaxhimin, përkatësisht përpjekjen për t'i kthyer paratë e investuara jashtë Kosovës.

Ministri Shala tha se sinqerisht i ka marrë me shumë seriozitet të gjitha sugjerimet dhe kritikën konstruktive dhe do përpiqet, që me stafin e tij, t'i reflektojnë në raportet e ardhshme çështjen e politikave investuese, politikat ekonomike, mënyrat e rialokimeve e të tjera.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për44,
Kundër.....22,
Abstenime..... 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18: 32 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**